



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prudato Received / Delivered	08.09.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Org. / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
6038/2023			1/2



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.953/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.953/2023, të datës 13.07.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson [redacted] avokat nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16. paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.09.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.953/2023, e datës 13.07.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

**II. Mbetet në fuqi** masa disiplinore “Vërejtje me shkrim”, e shqiptuar përmes shkresës me numër protokollit 3559, të datës 16.06.2023, të Drejtores Ekzekutive të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil, [redacted] (tutje vetëm ankuesi) më datë 13.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.953/2023, kundër masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” e shqiptuar përmes shkresës me numër protokollit 3559, të datës 16.06.2023, me pretendimet ankimore se shqiptimi i masës së kundërshtuar më ankesë është i njëanshëm, i pabazuar, i pa arsyeshëm, jo profesional, pa bazë ligjore dhe në kundërshtim të plotë me Udhëzimin Administrativ (BPZHR) Nr. 04/2022 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për masën 7 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve”, nën masa 7.2 Zhvillimi i turizmit rural dhe agro-turizmit.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë, të Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 24.07.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në mbështetje të dispozitave të nenit 17, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokoll 5836/2023, të datës 28.08.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.953/2023, të datës 13.07.2023.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova:*** Ankesën me numër protokoll 5178/2023, të datës 13.07.2023, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim me Nr.3559, të datës 16.06.2023, e shqiptuar nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit; Autorizimin nga përfaqësuesi me autorizim i ankuesit; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit të ankuesit me Nr.2386 të datës 08.06.2018; Akt emërimit e ankuesit me Nr.24 të datës 04.01.2013; Planin e aplikimit-miratimit PZHR 2022; Listën kontrolluese për vlerësimin e Planit të Biznesit dhe Projekt Propozimit PZHR-2022 të datës 11.10.2022; Letër informimin mbi vlerësimin e aplikacionit të datës 11.10.2022; Komunikimet elektronike të datës 13.10.2022, 12.10.2022 ndërmjet ankuesit dhe personave gjegjës të institucionit të AZHB-së; Projektin ideor për renovimin e objektit ekzistues (restorantit) i periudhës gusht 2022; Raportin nga kontrolli në teren të datës 02.11.2022 së bashku me shkresat e bashkangjitura të tij; Letër informimin-miratimin e projektit me Nr.5522 të datës 12.12.2022; Kontratën për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural Nr.339/2022 me numër protokoll Nr.Prot.6038 të datës 21.12.2022; Komunikimet elektronike të datës 25.05.2023, 31.05.2023, 30.05.2023, 09.06.2023, 07.06.2023 ndërmjet ankuesit dhe personave gjegjës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 24.07.2023 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 21.03.2018; Biznes planin për renovimin e bujtinës ekzistuese për masën 7-Difersifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve nën masën 7.2 të vitit 2022; Rekomandimin me Nr.Prot.04/22 të datës 05.08.2022 nga Grupi Lokal i Veprimt Natyra; Letër rekomandimin e datës nga GLV "Agro Prishtina"; Deklaratën nën betim/zotim për saktësinë e të dhënave të prezantuara me aplikim të datës 07.08.2022 nga [redacted] Certifikatën e regjistrimit të biznesit me numër 811340190 të datës 09.08.2019 për ID Project SH.P.K së bashku me dokumentet përcjellëse të biznesit; Diplomën me Nr.328/20 të datës 09.03.2020 nga Kolegji AAB për [redacted] së bashku me shkresën noteriale me numër LRP.Nr.Rendor 1728/2021 dhe komunikimet elektronike të datës 25.05.2023, 26.05.2023, 09.06.2023, 07.06.2023 ndërmjet ankuesit dhe personave gjegjës të institucionit; Procesverbalin mbi seancën dëgjimore të datës 31.08.2023 nga Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në Këshill; Komunikimet elektronike të datës 31.08.2023, 28.08.2023 lidhur me dërgimin e ftesave për seancë publike në Këshill për zyrtarët e ministrisë në fjalë; Njoftimin me numër Ref.07/4/1/896/2023 të datës 09.06.2023 lidhur me ndërprerjen e kontratës nga Drejtori i Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave të AZHB-së; Vendimin me Nr.Prot.4906 të datës 09.08.2023 të Komisionit për Shqyrtimin, Vlerësimin dhe Vendosjen e Ankesave; Vendimin me Nr.Prot.3390 të datës 13.06.2023 për kthimin e mjeteve financiare nga përkrahja publike; Shkresën zyrtare me Nr.Prot.2862 të datës 22.05.2023 lidhur



me listat e përfituesit të paradhënies për masën 7 për programin e vitit 2022; Vendimin me Nr.Prot.2863 të datës 22.05.2023 lidhur me paradhënien për mbështetje nga programi i zhvillimit rural të Drejtoreshës Ekzekutive të AZHB-së; Kërkesën për avans 2022 të aplikueses [redacted] të datës 17.05.2023; Kopjen e Pasaportës për X.H.M; Shkresën zyrtare të datës 18.03.2023 nga TEB lidhur me detalet për pranim nga jashtë; Sigurimin e avansit lidhur me garancionin me kërkesë të parë të datës 17.05.2023; Vlerësimin e raportit të inspektorit të datës 03.11.2022 nga AZHB-ja; Kopjen e letërnjoftimit për [redacted] Kontratën me Nr.Prot.6038 të datës 21.12.2022 për financimin e projekteve të zhvillimit rural Nr.339/2022; Letër informimin-miratimin e projektit me Nr.Prot.5522 të datës 12.12.2022; Komunikimet elektronike të datës 31.05.2023, 14.07.2023, 13.07.2023, 07.06.2023, 01.06.2023 ndërmjet zyrtarëve gjegjësisht të AZHB-së; Biznes planin e aplikueses [redacted] së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur lidhur me aplikimin për projektin në fjalë si dhe Vendimin VK/2023 të datës 25.08.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas seancës dëgjimore, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pabazuar, sepse:

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se, ankuesi është i punësuar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë( me tej referuar AZHB) dhe se i njëjti sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit me Nr.Prot.2386, të datës 08.06.2018, është emëruar dhe ushtron pozitën e punës Drejtor i Drejtorisë për Miratimin e Projekteve të Zhvillimit Rural.

Drejtoresha Ekzekutive në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në cilësinë e udhëheqëses së drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 16.06.2023 ka shqiptuar ndaj të njëjtit masën disiplinore “vërejtje me shkrim” me arsyetimin se, citojmë: *“Pas kontrollit të realizuar në terren nga ana e inspektorëve të AZHB-së me datë 02.11.2020 i cili ka vërtetuar se në vendin e ngjarjes nuk ka bujtinë ekzistuese, por një shtëpi e vjetër prej druri ku aktualisht është e rrënuar e shembur dhe në atë objekt nuk mundën të bëhen renovime për ndërtimin e ri, ...Po ashtu vlen të theksohet se sipas planit të biznesit në tabelën 1-Asetet e aplikuesit në pikën 1.2 figuron Bujtinë ekzistuese në vlerë prej 40,000.00 euro. Raporti i kontrollit në terren është në kundërshtim me planin e biznesit me të cilin ka aplikuar fermerja. Me ç’rast i është miratuar projekti me Letër informimin-Miratimin e projektit me numër protokollit 07/4 5522 me datë 12.12.2022.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se masa disiplinore në fjalë është e pa bazuar, e pa arsyeshme jo profesionale, pa bazë ligjore dhe është në kundërshtim të plotë me U/A (MBPZHR) Nr.04/2022 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për masën 7 “Divesifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve” nën masa 7.2 -zhvillimi i turizmit rural dhe agro-turizmit, i njëjti kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj masën disiplinore “vërejtje me shkrim”, të datës 16.06.2023.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Kolegji i Këshillit me datë 31.08.2023, ka mbajtur seancë dëgjimore ku në cilësi të palëve në procedurë janë ftuar: Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë në cilësinë e Udhëheqëses së drejtpërdrejtë të ankuesit, Drejtori i Autorizimit të Pagesave si dhe ankuesi në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Miratimin e Projekteve të Zhvillimit Rural. Udhëheqësja e ankuesit në seancën dëgjimore deklaroi, se: *“çështja e ankuesit është ngritur nga inspektorët në tren për shkak se ishte gjetur së objekti që është paraparë nuk është ndërtuar, dhe menjëherë kam ftuar drejtorin në takim dhe e kam pyetur lidhur me këtë, ka deklaruar*



se renovimi dhe rindërtimi janë fjalë të njëjta ndërsa sipas udhëzimit nuk është, lënda është e qartë prej raportit të inspektorëve, planit të biznesit dhe fotografive që nuk ka aty objekt. Kam prit dhe kam bërë vërejtje disiplinore, pastaj fermerja i ka kthye mjetet monetare, ka bërë ankesë dhe ju ka refuzuar. Ndërsa ankuesi në deklarinimin e tij shton se” ... ato që tha znj. [redacted] nuk janë të qëndrueshme pasi që turizmi rural është specifik dhe nuk ka nevojë me pas objekt, dhe këtu ka aplikuar si person fizik dhe tek ta nuk kërkohet përvoja paraprake dhe nuk kërkohet dokument se a është marrë me atë biznes apo jo dhe përvoja është vetëm i vlerësimit por jo edhe i pranueshmerinë dhe në këtë rast merret parasysh NIF-i dhe nëse ai NIF ka qenë më i vjetër se dy vjet ai ka marrë pikë reale. Objekti ekzistues është çfarë është dhe në bazë të masës shtatë i plotëson kriteret e objektit rural, kërkesën për interpretim kemi bërë me datë 12.10.2022 dhe kemi marrë përgjigje nga znj. [redacted] e cila ka specifikuar se tek rastet e tilla nuk është me rëndësi forma e objektit ekzistues por është me rëndësi që objekti të jetë funksionale i stilit rural dhe ai përshtatet objektivave të vendit të punës dhe rritjes së zonave rurale që është objektiv kryesor e kësaj mase. Në bazë të inspektimeve të inspektorëve kanë konstatuar se në projekt shkruan qartë se krijimi i kushteve dhe projekti është proceduar tutje. E rëndësishme për çka është vërejt se kur kanë shkruar inspektorët ne raportin e parë në teren gjoja kanë konstatuar se objekti që e kanë quajtur bujtinë. Problemi kryesor është se inspektori nuk e ka kuptuar termin renovim por në bazë të Udhëzimit këtu është keqkuptuar sepse renovim do të thotë kthimin e objektit ekzistues në kushtet e pranueshme duke bërë ripërtëritjen, dhe nëse objekti është rrëzuar në themele ka drejtë me u rindërtuar në themelet ekzistuese dhe plotëson të gjitha kriteret. Përveç kësaj me procedura IPARD të cilat i zbatohet termi renovim do të thotë një aktivitet ndërtimi për të kthyer një ndërtesë në një formë më të mirë për të pastruar riparuar apo rindërtuar, dhe për këtë nuk duhet leje. Me këto procedura nuk përzihem në vlerësim dhe miratim derisa projekti vjen tek unë, atëherë e miratoj, ndërsa projekti është miratuar nga [redacted] ..por me kërkesë të kryeshefes dhe timen zyrtarët kanë dhënë sqarime konkrete se projekti ne fjale i ka plotësuar kriteret. Me datë 25.05.2023, dikush e ka ngritur si çështje se gjoja projekti nuk i ka plotësuar kriteret dhe pa marrë rekomandim menaxhmenti e ka bërë shfuqizimin e kontratës dhe duke parë gabimin ma ka dhënë vërejtjen...”. Ndërlidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kolegjit ankuesi thekson: “si Udhëheqës i Departamentit për Miratimin e Projekteve, kam bërë aprovimin e projektit në fjalë...Para miratimit të projektit duhet shkruar kontrolla e parë dhe bëhet verifikimi i gjendjes në teren, inspektorat për kontroll në teren e bëjnë.... gjithë projekti i ka plotësuar kriteret me qenë përfitues i mundshëm.... gjatë procesit të vlerësimit zyrtarët kanë rënë në lajthitje pak lidhur me këto fotografi të projektit se a i plotëson kriteret dhe kanë kërkuar opinion tek politikbërësit dhe atëherë jam kam i njoftuar CC, dhe me rëndësi që objekti ekzistues është i stilit rural dhe se rëndësia sipas tyre është se si do të bëhet projekti që do të miratohet. Zyrtarët pa më pyetur mua kanë konstatuar se objektet plotësojnë të gjitha kriteret. Drejtori i Autorizimit të Pagesave z. [redacted] në pyetjet e Kolegjit deklaroi : “Pas miratimit të projektit analizojmë lëndën dhe autorizojmë për pagesë. Për rastin konkret ky projekt e ka zanafillën ne planin e biznesit, këtu s’ka pasur bujtinë dhe nuk ka pasur afarizëm, ka të dhëna të rrejshme në planin e biznesit dhe drejtori-ankuesi nuk ka mund te shoh se ka pasur rast shumë dhe këtu nuk thuhet për bujtine por thuhet restaurant. Inspektori thotë nuk ka kushte për renovim, unë kam adresuar email përfituese dhe nuk kane ofruar dëshmi qe ka pas ndonjë bujtine dhe pse ka pasur biznes dhe nuk na ka kthyer asnjë email. Janë kthyer mjetet nga përfituesja dhe tash ka pasur ankesë nga përfituesja dhe ju është refuzuar. Ky projekt është ndërprerë me te drejtë”.



Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së masës disiplinore të kundërshtuar me ankesë, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45, më të cilin është përcaktuar se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”.*

Nenit 46, më të cilin është përcaktuar se: *“... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. ..4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.*

Nenit 47, paragrafit 1, më të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: *“Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”.*

Nenit 48, më të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore *“1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil.*

Nenit 50 paragrafi 1, i cili ka përcaktuar se: *“1.Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”.*

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, Kolegji i Këshilli ka analizuar aktin e kundërshtuar me ankesë, në ndërlidhje me deklarimet në seancën dëgjimore si dhe provat materiale të çështjes, dhe rrjedhimisht ka gjetur se Udhëheqësja e ankuesit ka vërtetuar drejtë përgjegjësinë disiplinore të ankuesit dhe në këtë mënyrë ka zbatuar drejtë ligjin material, me rastin e cilësimit të veprimeve të ankuesit si shkelje disiplinore, sipas nenit 46 paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase. ankuesi në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë për Miratimin e Projekteve të Zhvillimit Rural, me datë 12.12.2022, përmes shkresës me Nr.Prot.5522, kishte bërë aprovimin e Projektit “Renovimi i bujtinës ekzistuese” në vlerë prej 99.999.00 eurove, përfituese e të cilit projekt ka qenë aplikuesja me inicialet \_\_\_\_\_ dhe mbi bazën e këtij miratimi me datë 21.12.2022, është lidhur kontrata për financimin e projektit nr.339/22, në mes të Kryeshefit Ekzekutiv të AZHB-së dhe përfitueses së projektit si dhe është bërë pagesë në avancë në vlerë prej 29.999.70 euro. Rrjedhimisht, ankuesi kishte aprovuar projektin në fjalë edhe përkundër Raportit të inspektoreve të datës 02.11.2022, sipas të cilit raport është konstatuar se në vendin e ngjarjes pra në vendin ku duhet të bëhej rinovimi i objektit/bujtinës nuk ka ekzistuar ndonjë objekt-bujtinë, por vetëm një shtëpi e vjetër prej druri dhe guri e cila tashmë ishte e shembur, fakt ky që vërtetohet edhe përmes fotografive të bëra në vendin e ngjarjes dhe të dorëzuara edhe nga vet përfituesja me rastin e aplikimit.



Po ashtu, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se përfituesja me inicialet [redacted] kishte aplikuar në kuadër të Programit për Zhvillim Rural, Masa 7 Diversifikimi i Fermave dhe Zhvillimi i Bizneseve, nën masa 7.2 –Zhvillimin e turizmit rural dhe agro-turizmi, përmes Projektit “Rinovimi i Bujtinës Ekzistuese” ku si qëllim të këtij projekti ka prezantuar se pas rinovimit të bujtinës ekzistuese, do të përmirësohen kushtet e punës, higjiena dhe siguria e ushqimit si dhe komoditeti për qytetarët për shërbimet që do të bëhen në këtë bujtinë, përmirësimi i infrastrukturës si dhe nxitjen e qytetarëve për ardhje në këtë zonë rekreatuese, ndërsa si një nga objektivat bazë ka prezantuar krijimin e vendeve të punës (2 punëtorë të rregullt dhe 1 sezonal). Mirëpo, bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ka kundërthënie në mes të vet dokumentacionit të përcjell me rastin e aplikimit, sepse, sipas Planit Biznesor, emërtimi i Projektit është vendosur “**Rinovim i Bujtinës Ekzistuese**” ndërsa, sipas Projektit Ideor “**Renovim i Objektivit Ekzistues (Restoranti)**”, dhe se vlera e objektit që do rinovohej ishte deklaruar 40.000 euro, fakte këto që janë në jo përputhshmëri me faktet e vërtetuara nga inspektorët gjatë kontrollit.

Për vendosje të drejtë dhe meritore, Kolegji i Këshillit ka analizuar Rregulloren Nr.01/2012 për Detyrat, Përgjegjësitë, Kompetencat, dhe Strukturën Organizative të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (e aplikueshme deri me datë 30.08.2023) si dhe përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Drejtorisë për Miratimin e Projekteve të Zhvillimit Rural sipas të cilave Drejtori i Drejtorisë së Miratimit të Projekteve është përgjegjës për organizimin, menaxhimin dhe koordinimin e punës së drejtorisë në procesin e implementimit të PZHR.Ndjek procedurat e kontrollit administrativ për miratimin e projekteve dhe është përgjegjës për ndarjen e funksioneve dhe detyrave brenda drejtorisë dhe nivelet e raportimit, ndërsa si detyra kryesore janë përcaktuar “ *...Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme duke përgatitë raporte për rezultatet e përkrahjes dhe rekomandon ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë ; Zbatimi i skemave përkrahëse të programit për zhvillim bujqësor dhe rural dhe zbatimi i procedurave të përcaktuara; Përgatitja dhe rishikimi i formularëve për aplikim, listave të kontrollit dhe rishikim, aprovim ose ndryshim i kontratave për projektet e përzgjedhura në përputhje me kërkesat ”*, andaj, Kolegji mbi këtë bazë konstaton se përgjegjës lidhur me miratimin e projekteve është ankuesi në pozitën e Drejtorit të Departamenti për miratimin e projekteve, rrejdhimisht i njëjti pas vlerësimit administrativ të aplikacioneve nga ana e zyrtarëve përgjegjës të kësaj agjencie bënë aprovimin e projektit. E në këtë kontekst, në rastin konkret, zyrtarët [redacted] dhe [redacted], me datë 11.10.2022 kanë bërë vlerësimin e dokumentacionit të përfitueses [redacted] ndërsa, ankuesi më datë 12.12.2022, ka nënshkruar letër informimin-miratimin e projektit në fjalë, edhe pse në dosjen e rastit ekzistonte raporti i kontrollit të parë i datës 02.11.2022, përmes të cilit ishin evidentuar parregullësi gjegjësisht që objekti ekzistues siç pretendohet në kërkesën për përfitim të projektit, nuk ekziston si tillë.

Kolegji, po ashtu si fakt relevant për vendosje të kësaj çështje disiplinore mori parasysh edhe Vendimin Nr.291/2023, të datës 09.08.202, të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sipas të cilit ishte konstatuar se në vendin e investimit ku dëshmohet qartë se objekti është i rrënuar dhe nuk mund të rinovohet dhe se AZHB-ja me rastin e nxjerrjes se Vendimit numër protokoll 3390 të datës 13.06.202, ka vepruar në pajtim me U/A Nr.04/2022 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitin 2022.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje juridiko administrative si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 45 të Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “*Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimt të paligjshëm apo mosveprimt;” 1.2. kryerjen e*



veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit” si dhe nenit 50 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: “Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore”, ka konstatuar së në rastin e ankuesit, janë plotësuar të gjitha elementet e përgjegjësisë disiplinore dhe se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit është në proporcion me shkeljen e kryer, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara ligjërisht.

Përmbledhur si më sipër, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në nenin 8 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.953/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesit Av. [REDACTED]
- Drejtoreshës Ekzekutive në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së